

VENDIM
Nr.889, datë 11.6.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE
KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES
VENDORE, KOMUNA FUSHË KUQE, TË QARKUT TË LEZHËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Fushë Kuqe, të qarkut të Lezhës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 5 (pesë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Fushë Kuqe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULARE PER TRANSFERIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Sipas inventarizimit te pronave te vecanta te tipit, Pyje, Kullota, Livadhe, Shkembore etj)

Institucioni I Pushtetit Qendrore: M.M.P.A.U										
Komuna Fushe-Kuqe										
Nr. rendor	Nr. sipas invent.	Emertesa e Ekonomise Pyjore dhe Kullosore (EPK) Shtrirja Gjeografike e EPK	Emertesa e Ngastres end ndodhja (sipas emertes popullore)	Numeri i Ngastres	Destinacioni	Superfaqja ne ha.	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni/ Enti me pergegjesi administrative	Institucioni/ Enti Perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	23	Ekonomi pyjore "Fushe- Kuqe"	Alku	4a	P.mbrojtjes	14.5	Bosh	MMPAU	DSHP Kurbin	Pyje shteteror
2	24	Ekonomi pyjore "Fushe- Kuqe"	Alku	4b	P.mbrojtjes	7.5	Zallishite	MMPAU	DSHP Kurbin	Pyje shteteror
3	25	Ekonomi pyjore "Fushe- Kuqe"	Plepishija e Gurzit	5a	P.mbrojtjes	8.8	Bosh	MMPAU	DSHP Kurbin	Pyje shteteror
4	25/1	Ekonomi pyjore "Fushe- Kuqe"	Plepishija Vjeter Gurzit	5b	P.mbrojtjes	12	Thupra	MMPAU	DSHP Kurbin	Pyje shteteror
5	52	Ek.Kullosore	Ura Ushitarit	5d	Kullote	78.1		MMPAU	"	"

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Fushë Kuqe

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
23-25, 25/1, 52	Sipërfaqe pyjore, kullotë	Në pronësi